VENDIM
Nr.638, datë 20.9.2006

PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE NË NGRITJEN E USHTRISË KOMBËTARE AFGANE DHE USHTRISË KOMBËTARE IRAKENE, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Heqjen nga armatimi i forcave të armatosura të municioneve, sipas llojeve, tipeve dhe sasive, të përcaktuara në pasqyrën "A", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Municionet e hequra nga armatimi, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të shërbejnë si kontribut i Qeverisë Shqiptare për ngritjen e Ushtrisë Kombëtare Afgane dhe Ushtrisë Kombëtare Irakene, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra A

Emërtimi i municionit	**Shteti prodhues**	**Koha e prodhimit**	**Sasia**	**Pesha**
Fishekë 7.62x54 mm të zakonshëm	Kina	1965-1970	500.000 copë	10.5 ton
Predha 82 mm mortaje	Kina	1970-1972	2000 copë	10 ton
Shuma			**502 000**	**20.5 ton**